



SmGP

PROGRAMI I GRANTEVE TË VOGLA 2007

Udhëzues për Organizatat e Shoqërisë Civile

Angazhimi qytetar i të rinjve

Kërkesë për propozime

Këtë vit fokusi i Programit të granteve të vogla për Shqipërinë do të jetë **Angazhimi qytetar i të rinjve**. Përmes projekteve të Programit të Granteve të Vogla ne do të dëshironim t'ju jepnim zë grupeve të të rinjve dhe të ndihmonim që nevojat dhe shqetësimet e tyre të merren parasysh në hartimin e politikave dhe programeve. Do të mbështeten me financime projekte që trajtojnë angazhimin qytetar të të rinjve, përgjegjshmërinë sociale, qeverisjen, arsimin, zhvillimin social – ekonomik, korrupsionin, emigrimin e trurit, mbrojtjen e mjedisit etj.



Mbi Programin

Programi i Granteve të vogla mbështet aktivitetet që lidhen me angazhimin qytetar, duke siguruar grante të vogla që administrohen nga Zyrat Lokale të Bankës Botërore. Programi i Granteve të vogla mbështet aktivitete që i mundësojnë qytetarët të ndërmarrin iniciativa për të rritur ndikimin e tyre tek rezultatet e zhvillimit. Aktivitetet që synohen të mbështeten do të forcojnë mekanizmat për përfshirje, përgjegjshmëri dhe pjesëmarrje të qytetarëve. Gjithashtu, ato forcojnë partneritetin me sektorin publik, organizatat e tjera të shoqërisë civile dhe sektorin privat.

Çfarë është angazhimi qytetar?

Angazhimi qytetar perkufizohet si nderveprim i qytetareve, individeve apo grupeve te organizuara me sektorin publik per te forcuar mekanizmat e perfshirjes, pergjegjshmerise dhe pjesemarrjes nepermjet ndikimit te rezultateve te proceseve te zhvillimit.

Angazhimi qytetar mund...

- **Të nxisë konsensusin publik dhe pronësinë lokale** për reforma dhe strategjinë e zhvillimit social-ekonomik të vendit dhe strategji të tjera të zhvillimit duke krijuar rrjete të shpërndarjes së njohurive e eksperiencave, duke nxitur bashkëpunimin e sektorit privat me atë publik, apo uljen e tensioneve e nxitjen e pajtimeve;
- **Të bëjë të dëgjohen shqetësimet e aktorëve primarë dhe sekondarë**, vecanërisht popullsisë së varfër dhe të mënjanuar, dhe të ndihmojë që ky zë të përfshihet në programet dhe politikat vendimmarrëse;
- **Të forcojë ndikimin e programeve të zhvillimit** duke ofruar njohuritë lokale, identifikuar rreziqet e mundshme, nevojën për asistencë dhe të zgjeroje rrethin e perfituesve, vecanërisht në nivelin lokal;
- **Të sjellë ide dhe zgjidhje novatore për sfidat e zhvillimit** në nivel lokal dhe global;
- **Të përmirësojë transparencën publike dhe përgjegjshmërinë** në programet e zhvillimit duke kontribuar në krijimin e një mjedisi të qeverisjes së mirë.

Para se të aplikoni

Programi i Granteve të Vogla mund të financojë vetëm një pjesë të vogël të kërkesave që i paraqiten. Shumë nga këto kërkesa nuk mund të merren parasysh, jo sepse janë të pajustificuara, por sepse nuk i plotësojnë kriteret ose qëllimet e Programit të Granteve të Vogla. Aktiviteti i propozuar mund edhe të plotësojë kriteret ose qëllimin e programit, por kërkesa për financim tejkalon fondet e disponueshme.

Para se të aplikoni, ju lutemi të lexoni Udhëzuesin për të parë nëse propozimi juaj përmbush kërkesat.

Kush mund të aplikojë?

- Çdo organizatë vendase e shoqërisë civile që punon për problemet e zhvillimit mund të aplikojë për një grant;
- Organizatat e shoqërisë civile duhet të kenë pozita të forta, të kenë shënuar arritje gjatë aktivitetit të tyre në komunitet dhe të kenë besueshmëri financiare;
- Do t'u jepet përparësi organizatave të cilat nuk janë mbështetur nga ky Program gjatë viteve të mëparshme (organizatat nuk mund të zgjidhen për më shumë se 3 grante nga Programi i Granteve të Vogla brenda një periudhe 5 – vjeçare).

Ç'loj aktivitesh do të mbështeten?

Programi i Granteve të Vogla mbështet aktivitetet objektiv parësor i të cilave është **angazhimi qytetar i të rinjve**. Projektet e paraqitura mund të:

- **Nxisin një pjesëmarrje më të madhe qytetare dhe diskutim** në nivel kombëtar dhe lokal mbi çështje që lidhen me masat antikorrupsion;
- **Përmirësojnë cilësinë e aktiviteteve sociale për transparencën publike dhe përgjegjshmërinë** në fusha të ndryshme të zhvillimit, duke kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes qytetare;
- **Përmirësojnë transparencën publike dhe përgjegjshmërinë e qeverisë** nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së individeve dhe komuniteteve për informim dhe monitorim të qeverisjes;
- Rrisin përgjegjshmërinë publike për një **akses dhe cilësi të përmirësuar të shërbimeve bazë**;
- **Forcojnë mekanizmat e përgjegjshmërisë** për avokati dhe përfshirje në rritje të qytetarëve dhe shoqërisë civile për të ushtruar presion për përmirësimin e shpërndarjes së shërbimeve publike dhe aktivitetit të strukturave politikë-bërëse;
- **Bëjnë të dëgjohen shqetësimet e aktorëve primarë dhe sekondarë**, vecanërisht popullsisë së varfër dhe të mënjanuar, dhe ndihmojnë që ky zë të përfshihet në programet dhe politikat vendimmarrëse;
- **Rishikojnë kuadrin ligjor mbi angazhimin qytetar dhe përgjegjshmërinë sociale**. Bëjnë rekomandime për përmirësimin e këtij kuadri ligjor.

Aktivitetet mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me forume, seminare dhe workshope për të rritur aftësitë dhe/ose njohuritë e angazhimit qytetar; fushata komunikimi për të ndikuar hartimin e politikave dhe shpërndarjen e shërbimeve publike; ose bashkimin e përpjekjeve për ngritjen e kapacitetit të një sektori të veçantë.

Aktiviteti duhet të mbyllet brenda një viti nga data e dhënies së grantit.

Prioritetet do t'u jepet organizatave që nuk janë mbështetur nga Programi në vitet e shkuara.

Ç'loj aktivitesh nuk do të mbështeten?

Grantet e Vogla nuk mund të financojnë: programe kërkimore, programe trajnimi akademike, projekte aktive, ofrimin e shërbimeve bazë, mbështetje të vazhdueshme institucionale (p.sh. pajisje), bursa, programe studimi, aplikime individuale, ose të enteve të pالةgalizuara. Veprimtaritë e propozuara nuk duhet të konkurrojnë ose zëvendësojnë instrumentat e Bankës Botërore; ato duhet të jenë në mënyrë të qartë të dallueshme nga programi normal i Bankës.

Madhësia e Grantit?

Madhësia e grantit varion nga 3,000\$ deri në 7,000\$. Programi i Granteve të Vogla rrallë mund të financojë mbi gjysmën e buxhetit të parashikuar për një aktivitet, duke preferuar të bashkëfinancojë me donatorë të tjerë. Organizatave aplikuese u kërkohet të shpjegojnë se si granti nga Banka Botërore mund të ndihmojë për marrjen e fondeve plotësuese nga donatorë të tjerë.

Si aplikohet për një Grant?

Programi i Granteve të Vogla administrohet nga zyrat lokale të Bankës Botërore. Jo të gjitha zyrat lokale administrojnë një Program Grantesh të Vogla. Kërkesat dhe propozimet nuk duhet t'i dërgohen zyrove qendrore të Bankës Botërore, sepse vendimet nuk merren atje.

Udhëzuesit dhe formularët e aplikimit mund të tërhiqen pranë zyrës së Bankës Botërore në Tiranë, gjatë gjithë muajit janar. Programi i Granteve të Vogla i merr vendimet vetëm një herë në vit. Organizatat aplikuese duhet të aplikojnë të paktën katër deri në gjashtë muaj më parë nga data e aktivitetit. Aplikatët këshillohen të lexojnë me kujdes kriteret dhe formularin e aplikimit përpara paraqitjes së aplikimit në zyrat lokale të Bankës Botërore.

Fituesit e projekteve vendosen nga Komisioni i Granteve të Vogla, i mbledhur në zyrën lokale të Bankës Botërore. Aplikimet studiohen dhe rishikohen për t'u siguruar që përputhen me kriteret e vendosura. Programi i Granteve të Vogla i kushton vëmendje të plotë të gjitha propozimeve. Shqyrtimi i tyre mund të kërkojë deri në katër muaj kohë.

Informacioni mund të gjendet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Bankës Botërore: <http://www.worldbank.org.al>

Si vlerësohen aplikimet?

Komisioni i Programit të Granteve të Vogla i vlerëson aplikimet në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- A do të promovojë granti dialog të frutshëm dhe shpërndarje të informacionit me objektiv rritjen *angazhimit qytetar të të rinjve?*
- A është kërkuar granti për një aktivitet të vetëm?
- A përfundon aktiviteti brenda një viti?
- A shërben granti për të gjeneruar fonde shtesë nga donatorë të tjerë?
- A është grantkërkuesi organizatë vendase?

Cilat grante kanë prioritet?

Ndërsa gjithë aplikimet që përmbushin kriteret e mësipërme janë të pranueshme për financim, Komisioni i PGV u jep prioritet:

- Aktiviteteve që nxisin lidhje aktive dhe bashkëpunim midis grupeve të ndryshme si komuniteteve, organizatave komunitare, OJQ-ve lokale, pushtetit lokal, sektorit privat etj.;
- Aktiviteteve që jo vetëm identifikojnë problemin, por ofrojnë zgjidhjen për të;
- Aplikimeve që merren 3-4 muaj para aktivitetit të propozuar dhe dëshmojnë se financimi i Bankës Botërore ndihmon në gjenerimin e financimeve shtesë nga donatorë të tjerë;
- Aplikimeve të organizatave që nuk janë kontraktuar më parë nga Banka në ndonjë nga projektet e financuara nga ajo.